



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES
SENATI

Sheshi: "Nënë Tereza", Nr. 1, Tiranë

Tel/Fax: 227914

www.upt.al

Tiranë më, 28.01.2016

VENDIM Nr. 1

Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në Universitetin Politeknik të Tiranës

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimin Nr. 52 datë 03.12.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e studimit të ciklit të parë dhe të tretë, në Institucionet e Arsimit të Lartë", Senati i UPT

VENDOSI:


1. Kandidatët, të cilët aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimit të ciklit të dytë, apo të tretë duhet të kenë kompetencë gjuhësore në një nga 5 (pesë) gjuhët e huaja: Gjuhën Angleze, Gjuhën Frënge, Gjuhën Gjermane, Gjuhën Italiane dhe Gjuhën Spanjolle.
2. Niveli minimal i pranueshëm kompetencës gjuhësore të jetë si më poshtë
 - a) **Niveli B1** (kompetencë operative e mjaftueshme gjuhësore) – për programet e studimit të **ciklit të dytë**
 - b) **Niveli C1** (kompetencë operative e kënaqshme gjuhësore) – për programet e studimit të **ciklit të tretë**
3. Ngarkohen Sekretaritetë mësimore të Fakulteteve të shpallin këtë vendim dhe listën e niveleve të njohjes së gjuhëve të huaja dhe testeve ndërkombëtare (sipas shtojcës së Nr. 52 datë 03.12.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit):
4. Studentët e regjistruar në ciklin e dytë apo të tretë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë, të cilët nuk i janë nënshtruar testimit të gjuhës angleze, si dhe

nuk kanë paraqitur dokumentacion pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, sipas Udhëzimit 14, date 28.3.2011., “Për njohjen e testimeve dhe certifikimeve për gjuhën angleze për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë”, dhe Vendimit Nr. 20 datë 17.10.2014 të Senatit të UPT, kryejnë testimin sipas këtij vendimi.

5. Për pranimin/kontrollin dhe verifikimin e Certifikatave/dokumentacionit të gjuhës së huaj ngarkohen sekretaritetë mësimore të Fakulteteve;
6. Për studentët e regjistruar tashmë në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë dhe nuk kanë dorëzuar dokumentacionin e nivelit të njohjes së gjuhës së huaj afati maksimal i dorëzimit të dokumentacionit për nivelin e njohjes së gjuhës së huaj është pra mbrojtjes së diplomës/tezës;
7. Më tej dokumentacioni i njohjes së gjuhës së huaj do të jetë pjesë e dokumentacionit të aplikimit për hyrjen në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në Universitetin Politeknik në përputhje me pikën 3 të udhëzimit 52 datë 03.12.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
8. Bashkëngjitur me këtë vendim është “Lista e niveleve të njohjes së gjuhëve të huaja” dhe “Lista e subjekteve të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale mbi testimet ndërkombëtare”;
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Senatit

Akademik Jorgaq KACANI



The image shows a handwritten signature in black ink, which appears to be 'J. Kacani'. To the right of the signature is a circular official stamp. The stamp contains the text 'FACULTETI I EDE' at the top and 'UNIVERSITETI POLITEKNIK TIRANE' at the bottom. In the center of the stamp, there is a smaller emblem or logo.

Tabela 1

Në mbështetje të Kuadrit të Referencave për Gjuhët të krijuar nga Këshilli i Europës (2001), Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët, si dhe në bashkëpunim me Ambasadat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Francës, Italisë dhe Spanjës të akredituara në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, njeht testet e gjuhëve të huaja dhe nivelet si më poshtë:

| Niveli | B1 | B2 | C1 |
|--|-----------------------|------------------------|-----------------------|
| <i>Gjuha angleze</i> | | | |
| Cambridge | PET | FCE | CAE |
| IELTS | 4.0 / 5.0 | 5.5 / 6.0 | 6.5 / 7.0 |
| TOEFL Internet-based Test (iBT) | 57/86 | 87/109 | 110/120 |
| TOEFL Paper-based Test (ITP) | 460 | 543 | 627 |
| TOEIC | 381 / 649 | 650 / 785 | 786 / 935 |
| GESE | - | 7, 8, 9 | 10, 11 |
| APTIS | Aptis B1 | Aptis B2 | Aptis C |
| <i>Gjuha gjermane</i> | | | |
| Goethe-Institut | ZD | ZDFB | ZMP |
| TestDaF | - | TDN 3 - TDN4 | TDN 5 |
| <i>Gjuha franceze</i> | | | |
| TFI | 345/604 | 605/824 | 825 |
| DELF | DELFB1 | DELFB2 | DALFC1 |
| TCF | TCF 300 - 399 | TCF 400 - 499 | TCF 500 - 599 |
| TEF | TEF 361-540 | TEF 541-698 | TEF 699-833 |
| <i>Gjuha italiane</i> | | | |
| Peruggia | CELI2 livello2 | CELI3 livello3 | CELI4 livello4 |
| Sienna | CILS uno B1 | CILS 2 | CILS 3 |
| <i>Gjuha spanjolle</i> | | | |
| DELE | DELE inicial | DELE intermedio | DELE superior |

